

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“DHD Group Shpk”**

Sot, në datën 15.03.2024 themeluesi:

- **Z. Qazim Doçi, shtetas shqiptar, lindur në Peshkopi, më 09/06/1996, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me numër ID: J60609006L**
- **Z. Perikli Dhimojani, shtetas shqiptar, lindur në Himarë, më 27/04/1993, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me numër ID: J30427050K**

me vuillnet të lirë të plotë e të sinqertë, dhe inisiativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Civil në fuqi, ligjin Nr. 9901 datë 04.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", vendosi të themelojë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi te kufizuar, me emërtimin **DHD Group Shpk**.

**Neni 1  
Themelimi**

**1.1 Emri i shoqërisë është DHD Group Shpk.**

**1.2 Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.**

**1.3 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.**

**Neni 2  
Objekti**

Shoqëria **DHD Group Shpk** do të ketë objekt veprimitarie:

- Sherbime ne fushen e bareve, restoranteve si dhe kryerjen e sherbimeve catering (shperndarje) lidhur me prodhimet e mesiperme.

Sidoqoftë, asgjë nuk do të interpretohet këtu si kufizim i mundësisë së shoqërisë për të hyrë në tregje apo aktivitete dhe operacione të tjera tregtare që janë të lidhura me apo në funksion të objektit të mësipërm. Objekti i aktivitetit te Shoqerise mund te ndryshohet dhe/ose zgjerohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe kete Statut.

**Neni 3  
Kohëzgjatja**

**3.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat të pakufizuar, me përjashtim të rastit kur Asambleja e Ortakëve, sipas kuorumi përkatës vendos ndryshe.**

- 3.2** Shoqëria **DHD Group Shpk** gjëzon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tillë në regjistrin tregtar të QKB-së.

**Neni 4**  
**Selia**

- 4.1** Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “Teodor Keko”, zona: 19 nr .6, prona nr. D-03  
**4.2** Gjatë veprimtarisë së saj, shoqëria ka të drejtë të krijojë dhe hapë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi edhe në qytete të tjera, brenda dhe/ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin e kërkuar në fuqi sipas juridiksionit të vendit përkatës.

**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

- 5.1** Kapitali i regjistruar i shoqërisë është **100 Lekë** (njëqind lekë), i barabartë me 2 (dy) kuota. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë.  
**5.2** Pjesëmarrja e Ortakëve në kapitalin e shoqërisë është në raport me kontributin e derdhur prej tyre dhe vlera nominale e kuotës te secilit ortak, llogaritet në raport me secilin kontribut, e paraqitur në mënyrë të përmbledhur sipas grafikut të mëposhtëm:

Nr.	Emri i Ortakëve	Kuota	Kontributi i ortakëve në kapital (lekë)	Perqindja ne kapital
1.	<b>Z. Qazim Doçi</b>	1	50	50 %
2.	<b>Z. Perikli Dhimojani</b>	1	50	50 %
<b>Totali</b>		<b>2</b>	<b>100</b>	<b>100 %</b>

- 5.3** Kontributet sa më sipër janë nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga ana e ortakëve të shoqërisë.

**Neni 6**  
**Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar**

- 6.1** Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave të ortakëve në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

- 6.2** Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar te shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave (tre të katërtat) në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit, duke pasur parasysh qe te respektohet minimumi i parashikuar nga Ligji per Shoqerite Tregtare.

**Neni 7**  
**Kuotat dhe Kalimi i Kuotave**

- 7.1** Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim ndërmjet paleve.  
**7.2** Transferimi i kuotave të ortakëve të shoqërisë brenda ortakërisë apo në drejtim të personave të tretë jashtë ortakërisë është i kushtëzuar në cdo rast nga ushtrimi i të drejtës së parablerjes në favor të ortakëve ekzistues.

*Faqe 2 nga 6*  
*Akti i Themelimit*  
*“Dhd Group” shpk*

Ortakët, para se t'i transferojnë në cdo forme kuotat e veta një ortaku ekzistues brenda shoqërisë apo një personi të tretë jashtë saj, detyrohet të njoftojë me shkrim paraprakisht të gjithë ortakët ekzistues nëse dëshirojnë të blejnë kuotat me të njëjtat kushte ekonomike si dhe në menyrë përpjestimore sipas kuotave që zoterojnë në kapital të shoqerise.

Në rast se të gjithë ortaket nuk përgjigjen me shkrim brenda 20 ditëve nga njoftimi apo deklarojnë se nuk dëshirojnë të blejnë kuotat, ortaku është i lirë të transferojë kuotat e tij tërësisht apo pjesërisht në drejtim të personave të tretë jashtë ortakërisë.

Në rast se një pjesë e ortakëve ekzistues përgjigjen me shkrim brenda 20 ditëve dhe deklarojnë se dëshirojnë të blejnë kuotat, ortaku është i detyruar ti transferojë kuotat e tij në drejtim të tyre në mënyrë të barabartë.

#### Neni 8

#### Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit

- 8.1 Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotëruesh ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotërueshve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gjëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarsësish parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjera.
- 8.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotëruesh ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër te caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotëruesh i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotëruesh i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.
- 8.3 Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gjëzonte zotëruesh i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit ne QKB.

#### Neni 9

#### Kompetencat dhe Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme do të vendosë, por pa u kufizuar, për çështjet e mëposhtme të Shoqërisë:
- përcaktimi i politikave tregtare;
  - ndryshime të Statutit;
  - emërimi dhe shkarkimi i administratorit/administratorëve;
  - emërimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - miratimi i skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c. dhe d.;
  - mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga ana e administratorit/ administratorëve, duke përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi securinë e aktivitetit të Shoqërisë;
  - miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve mbi securinë e aktivitetit të Shoqërisë;
  - zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
  - pjesëtimi i kuotave dhe anulimi i tyre;
  - përfaqësimi i shoqërisë në gjykime dhe në procedime të tjera kundër administratorit/administratorëve të saj;
  - riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë;

Faqe 3 nga 6

Akti i Themelimit

"Dhd Group" shpk



- l. miratimi i rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- m. çështje të tjera të parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare dhe Statuti.

**Neni 10**  
**Administratori**

**10.1** Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shume persona si Administratorë të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të janë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicën e votave te ortakeve ne Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.

**10.2 Caktohet si Administrator i shoqërisë DHD Group Shpk:**

Z. Qazim Doçi, shtetas shqiptar, lindur në Peshkopi, më 09/06/1996, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar , me numër ID: J60609006L, per një afat 5 vjeçar, nga momenti i regjistrimit te ketij fakti prane Qendres Kombetare te Biznesit.

**Neni 11**  
**Kompetencat e Administratorit**

- 11.1** Politikat tregtare të shoqërisë si dhe aktiviteti normal i saj do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sa më sipër dhe ligjt tregtar ne fuqi.
- 11.2** Pa u kufizuar sa me sipër, në mënyrë të vecantë, Administratori ka këto kompenteca:
  - do të drejtojë dhe të përfaqësojë Shoqerinë përsa i përket administrimit të zakonshëm;
  - do të nënshkruajë cdo marrëveshje në emër të Shoqërisë;
  - të hapë llogari në emër të Shoqerisë me cdo banke që kryen aktivitet në Shqipëri ose jashtë saj,
  - do të pergatisë të gjitha planet për marrjen e financimeve, do të nënshkruajë cdo kontratë huaje apo kontrate tjeter që parashikon një borxh apo borxh të mundshëm për Shoqerinë, hipotekë, peng apo cdo marrëveshje tjeter që krijon apo mund të krijojë një barrë mbi pasuritë e Shoqërisë, marrëveshje garancie, kontratë për shitjen e pasurive të paluajtshme apo të luajtshme të Shoqërisë. Të gjitha veprimet e parashikuara këtu (pika iv) do të janë të vlefshme nëse janë të autorizuara shprehimisht me anë të një Vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë unanime;
  - do të urdhërojë dhe kryejë pagesa në emër të Shoqërisë – duke nënshkruar dokumentet / instrumentet e pagesave;
  - do të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
  - do të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ia paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme;
  - do të kryejë regjistimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas kërkesave të Ligjit nr. 9723, datë 3 Maj 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"
  - do t'i raportojë Asamblesë së Përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rendësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
  - do të marrë në punë, emërojë, shkarkojë të punësuar të Shoqërisë për cdo nivel, përfshirë edhe të punësuar me kohë të pjesshme, konsulentë, agjentë, do të përcaktojë kompetencat dhe detyrat e tyre, si dhe do të përcaktoje shperblimin e tyre;

Faqe 4 nga 6  
Akti i Themelimit  
"Dhd Group" shpk

- të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, duke pasur parasysh respektimin në cdo rast të kufizimeve të parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhëna me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sa më sipër, ka të drejtë të ngrëjë padi përparrë gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

### **Neni 12 Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit**

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. ndodhet ose mund te ndodhet ne kushtet e pa-aftesise fizike ose mendore
4. jep dorëheqje nga detyra duke njostuar shoqërinë;
5. humb jetën
6. ndodhet në situata apo rrethana të cilat e bëjnë të pamundur ushtrimin e detyrave të tij;

### **Neni 13 Kufizimet në Veprimet e Administratorit**

- 13.1** Administratori nuk do të lidhë marrëveshje për çështje në të cilin ai ka, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit për shoqëritë tregtare, deri në momentin kur Asambleja e Përgjithshme e shoqerisë, në bazë të kuorumit te kerkuar, autorizon lidhjen e kësaj marrëveshje.
- 13.2** Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### **Neni 14 Shkaqet e prishjes së shoqërisë**

- 14.1** Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunkcionimit të vazduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare
- në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/I te ligjit per shoqerite tregtare;
- në raste të tjera, të parashikuara në statut ose ne ligj
- për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

- 14.2** Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të

- ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.
- 14.3 Administratori është i detyruar të regjistrojë prishjen e Shoqërisë në QKB, me përjashtim të rastit kur prishja bëhet me vendim gjykate; në këtë rast është gjykata që i dërgon njoftimin QKB-së.

**Neni 15**  
**Te Ndryshme**

- 15.1 Të gjitha marrëdhieniet e punës në shoqëri rregullohen me Kodin e Punës dhe cdo akt tjeter ligjor dhe nënligjor të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, në fuqi dhe në veprim kohe pas kohe gjate periudhës së ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar.
- 15.3 Viti finanziar zgjat 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 16.4 Në fund të cdo viti finanziar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, te cilët i dërgohen përmiratim Asamblesë së zakonshme.
- 16.5 Për të gjitha cështjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në fuqi, të azhornuar.

**Neni 16**  
**Mosmarrëveshjet**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

**NENI 17**  
**Dispozita perfundimtare**

- 18.1 Ky statut përbën dokumentin e vetëm të shoqërisë që parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarisë së shoqërisë. Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose tërësisht dhe të zëvëndësohet me një statut të ri vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve sipas shumicës së cilësuar të përcaktuar më sipër.
- 18.2 Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, ortakët do ti referohen legjisacionit tregtar Shqiptar në fuqi si dhe praktikave tregtare në vend.

Ky statut u redaktua në 2 ekzemplarë, me përbajtje dhe vlera të njëjtë juridike, në gjuhën Shqip dhe u nënshkrua nga ortaku themelues pa asnjë rezervë.

**O R T A K È T**  
**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“DHD Group Shpk”**

Perihli Nhimani  


Faqe 6 nga 6  
Akti i Themelimit  
“Dhd Group” shpk

Qazim Dosi  
